QUMËSHTI

ZINXHIRI I VLERËS PËR SEKTORIN E QUMËSHTIT

MARS 2020

RECURA
Agro Resource Center

PËRMBAJTJA

Hyrje 4
Zinxhiri I Vlerës 4
Përshkrimi I proceseve 5
Prodhimi 6
Cikli i prodhimit të qumështit 7
Grumbullimi i prodhimit vendor 7
Përpunimi 8
Konsumi 8
Shitja dhe Çmimi I tregut 9
Shembulli i biznesit në një fermë 10
Rentabiliteti pas laktacionit të tretë 10
Shpenzimet 10
Shpenzimet në investim 10
Kostot operacionale 12
Prodhimi dhe shitjet 13
Pasqyra e të ardhurave 15
Rrjedha e parasë 15

HYRJE

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë informata themelore mbi tregun e qumështit në Kosovë. Ky udhëzues synon të ndihmojë fermerët si edhe ekonomitë bujqësore aktuale dhe potenciale që të marrin vendime të duhura në bizneset e tyre. Udhëzuesi ju ndihmon të kuptoni më mirë strukturën, karakteristikat dhe praktikat bujqësore në sektorin e qumështit në Kosovë, si edhe ofron informata të dobishme mbi kapacitetet prodhuese dhe përpunuese të qumështit. Poashtu, këtu mund të gjeni analizën e kosto – benefitit të një ferme të qumështit, si shembull hipotetik për një biznes të ngjajshëm të ofruar në fund të këtij udhëzuesi.

Kosova ka një potencial mjaft të mirë për zhvillimin e blegtorisë në të gjitha rajonet kodrinore malore të cilat janë karakteristike për këtë lloj veprimtarie. Prodhimi i qumështit është i përqendruar kryesisht në fermat e vogla, i cili pastaj kalon përmes qendrave grumbulluese deri tek njësitë përpunuese. Qumështi është një produkt bazë për konsumim nga çdo familje në Kosovë. Kërkesa për qumësht është zakonisht stabile, qoftë si produkt primar apo i përpunuar, ndërsa oferta në vitet e fundit ka shënuar një rritje të lehtë. Qumështi vendor plotëson rreth gjysmën e kërkesës së nevojave të konsumimit, prandaj më tepër se sa gjysma tjetër importohet.

Në vitin 2018, lopët qumështore përfaqësojnë 51% të numrit të përgjithshëm të gjedheve. Prodhimi vendor i qumështit sipas Raportit të Gjelbër, në vitin 2018 ka qenë rreth 278 milion litra, e që është pak më i ulët sesa në vitin 2017 sepse edhe numri i lopëve qumështore ishte më i vogël. Konsumi vjetor i qumështit dhe produkteve të qumështit vlerësohet të jetë rreth 215 litra për kokë banori apo një person konsumon rreth 0.59 litra produkte të qumështit në ditë.

Për shkak të ndërlikueshmërisë së sektorit të qumështit, pjesa e parë e këtij udhëzuesi do t'i përshkruajë proceset kryesore të këtij sektori duke nënvizuar prodhimin, grumbullimin, përpunimin, shitjen dhe konsumin. Ndërsa pjesa e dytë e dokumentit do të fokusohet në një shembull hipotetik të një ferme lopësh qumështore duke nënvizuar shitjet, të hyrat dhe rrjedhën e parasë së parashikuar për një biznes të tillë.

ZINXHIRI I VLERËS

Kosova ka pasur gjithsejt 132,474 krerë lopësh në vitin 2018.
Produktet kryesore të fermave janë mishi dhe qumështi. Figura në vijim tregon lëvizjen e produktit të qumështit dhe funksionet kryesore vertikale nga poshtë – lart, prej prodhimit në nivel ferme e deri tek konsumatori. Lojtarët kryesorë, të cilët marrin pjesë në kryerjen e këtyre funksioneve realizojnë transaksione mes veti duke mundësuar kalimin e produktit nëpër hallkat kryesore dhe duke i shtuar vlerë produktit për të arritur deri tek konsumatorii final.

ZINXHIRI I VLERAVE PËR SEKTORIN E QUMËSHTIT



Figure 1. Zinxhiri i vlerës në sektorin e qumështit (Burimi: Recura Agro Qendër)

PËRSHKRIMI I PROCESEVE

Prodhimi

Nga sasia e përgjithshme e qumështit të prodhuar në fermat e Kosovës, rreth dy të tretat e sasisë konsumohet brenda fermave dhe një e treta dërgohet direkt tek qumështoret ose dërgohet përmes qendrave grumbulluese të qumështit. Sipas të dhënave të MBPZHR prodhimi i përgjithshëm i qumështit në vend në vitin 2018 ka qenë rreth 278 milion litra, sasi e cila paraqet rënie për 1% krahasuar me vitin paraprak. Gjatë periudhës së analizuar pesëvjeqare, rendimenti mesatar për krerë lope është nën 175 litra në muaj. Ky rendiment aktual është mjaft i ulët, dukshëm nën mesataren botërore dhe bile edhe nën normën e parashikuar komerciale të nevojshme.

Kategoria	Njësia	2014	2015	2016	2017	2018
Prodhimi i qumështit	**Ton**	**278,933**	**282,534**	**285,261**	**277,976**	**277,599**
Differenca ndër vite			3,601	2,727	- 7,285	- 377
Diferenca në përqindje			1.3%	1.0%	-2.6%	-0.1%
Lopë qumështore	**Krerë**	**134,393**	**135,801**	**136,783**	**132,971**	**132,474**
Differenca ndër vite			1,408	982	- 3,812	- 497
Diferenca në përqindje			1.0%	0.7%	-2.8%	-0.4%
Mujore Litra / lopë		**172.96**	**173.38**	**173.79**	**174.21**	**174.62**

Tabela 1: Prodhimi i qumështit dhe numri i lopëve qumështore ndër vite sipas raportit të gjelbër 2019

Numri i lopëve qumështore për periudhën 2014 deri në vitin 2018 mbetet i ngjajshëm. Një rritje e vogël për 1% është paraqitur në vitin 2015 dhe 0.7% në vitin 2016, ndërsa në vitin 2017, numri i lopëve qumështore ka rënë për -2.8% krahasuar me vitin paraprak dhe në vitin 2018 ka shënuar një rënie tjetër për -0.4% krahasuar gjithnjë me vitin paraprak. Ndërsa, prodhimi vjetor i qumështit ka pasur një rritje të lehtë deri në vitin 2016 ku ka arritur në mbi 285 milion litra/vit.

Një vit më pas, prodhimi i qumështit ka rënë për -2.6% ndërsa në 2018 krahasuar me 2017 u regjistrua një rënie tjetër prej -0.1% në prodhimin e qumështit. Njëra nga arsyet e rendimentit të ulët të shënuar në Kosovë lidhet edhe me varietetet mikse të lopëve të kultivuara në Kosovë, të cilat në shumicën e rasteve janë raca të përziera dhe jo të specializuara qumështore. Përveç kësaj ushqimi i përdorur për lopët qumështore në shumë raste nuk është kombinimi ideal për të nxitur rendimentin e lartë të qumështit.

Qumështi i lopës paraqet 97% të sasisë së përgjithshme të qumështit të prodhuar në vend. Ndërsa qumështi i deleve dhe dhive mbulon vetëm deri në 3% të sasisë së përgjithshme. Pjesa dërmuese e qumështit konsumohet në tregun vendor, direkt nga ferma apo përmes shitjes në tregun e gjelbër si qumësht i papërpunuar. Shumë pak produkte të qumështit eksportohen.

Cikli i prodhimit të qumështit

Sipas kalendarit të prodhimit të qumështit, viçat e gjinisë femrore që lindin mbahen në fermë për prodhimin e qumështit në të ardhmen. Në moshën 15-18 muaj, viçat janë të mbarësuar dhe pas nëntë muajsh mëshqerrat pjellin dhe fillojnë ciklin e parë të prodhimit të qumështit. Cikli i prodhimit të qumështit të lopëve qumështore fillon pas lindjes së viçit të parë dhe zgjat mesatarisht rreth 10 muaj, ndërsa një lopë del nga prodhimi pas 6 cikleve. Lopët mbahen në nxehtësi sapo të kalojnë periudhën 10 ditore pas pjelljes, zakonisht ato mbarësohen pas 30-60 ditësh. Fermerët e Kosovës zakonisht i mjelin lopët e qumështit për rreth 10 muaj (305 ditë) e cila përcillet me periudhën e thatë prej 60 ditësh. Në praktikë secila lopë lind gjatë sezonës së pranverës. Ndërsa kulminacioni i laktacionit për lopët qumështore të Kosovës është prej muajit Maj deri në Muajin Korrik. Cikli i prodhimit të lopëve qumështore që nga lindja është përshkruar në figurën vijuese.

Figure 3. Cikli i prodhimit të qumështit sipas periudhave; Burimi: Dairy Farming, Mary D.G Espiritu

Sipas regjistrit të subjekteve veterinare të licencuara nga AVUK në vitin 2019, në Kosovë janë gjithsejt 106 sosh të cilat ofrojnë shërbime dhe inpute të ndryshme për përkrahjen e ciklit të prodhimit.

Grumbullimi i prodhimit vendor

Përbrenda kategorisë së aprovimit të objekteve të ushqimit me prejardhje shtazore është e regjistruar vetëm një qendër grumbulluese, ndërsa nga burimet jo-zyrtare numërohen mbi 50 qendra grumbulluese të qumështit. Zakonisht grumbullimi i qumështit organizohet nga qumështoret të cilat ofrojnë transport adekuat me frigorifer për të grumbulluar qumështin nga njësia prodhuese.

Qumështi është një produkt i cili lehtë mund të prishet dhe për këtë arsye pas mbarimit të procesit të mjeljes duhet të ruhet si duhet. Pas mjeljes, qumështi pothuajse ka temperaturën e trupit dhe paraqet një mjedis të përshtatshëm për rritje të shpejtë të bakterieve. Duke pasur parasysh se sistemi i natyrshëm

pengues i qumështit kundër bakterieve zgjat vetëm 2-3 orë, pajisja me frigoriferë e qendrave grumbulluese apo transporti me ftohës është esencial.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka aplikuar pagesa direkte (subvencione) për qumështin sipas kategorive të cilësisë. Fermeri duhet të dorëzojë së paku 1,500 litra qumësht në qumështore të licencuar brenda periudhës tremujore (sipas tremujorëve të vitit kalendarik). Me këtë fermeri përfiton **0.06 €/litër** për qumështin e klasës ekstra, **0.04 €/litër** për qumështin e klasës së I-rë dhe **0.02 €/litër** për qumështin e klasës së II-të.

Përpunimi

Sipas regjistrit të Agjensionit të Ushqimit dhe Veterinës (AUV) të vitit 2019, gjithsejt janë 45 objekte të aprovuara për përpunim dhe paketim të qumështit në Kosovë, 7 prej të cilave për momentin janë jo-aktive. Subjektet aktive të cilat janë të shpërndara në rajone të ndryshme të vendit, prodhojnë produkte të ndryshme të qumështit si: qumësht i pasterizuar, qumësht UHT, jogurt, djathë i butë i bardhë, djathë kaçkavall, djathë sharri, gjizë, ajka, ajran, kos, vaj krem, mazë, speca me gjizë dhe akullore. Ndarja e ndërmarrjeve sipas kapacitetit të prodhimit është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Vëllimi i prodhimit (lit)	Nr. i ndërmarrjeve	Kapaciteti (lit/ditë)	Kapaciteti (Litra/vit)
Deri në 5,000	24	32,750	11,953,750
5,0000- 50,000	10	179,000	65,335,000
50,000- 200,00	3	380,000	138,700,000
Total	37	591,750	215,988,750

Tabela 2: Kapaciteti i instaluar për përpunimin e qumështit në qumshtoret në Kosovë sipas mad

Kapaciteti përpunues i qumështit tek ndërmarrjet vendore është dukshëm më i lartë se sa prodhimi i qumështit vendor i qumështit. 37 përpunues aktiv momental kanë kapacitet përpunimi total prej rreth 592 mijë litra qumësht në ditë apo rreth 216 milion litra në vit, e cila sasi llogaritet të jetë tregu vendor me shumicë për qumësht të freskët. Mirëpo, nga ana tjetër, afër dy të tretat e prodhimit të qumështit vendor mbetet në ferma për konsumim vetanak, për t'i ushqyer viçat apo për ta shitur në tregun e gjelbër, ndërsa vetëm një e treta e prodhimit vendor dërgohet tek ndërmarrjet përpunuese. Pra, nga sasia totale prej 278 milion litrash të qumështit të prodhuar në vend vetëm 93 milion litra dërgohet në përpunim, e cila sasi i përmbush vetëm 43% të kapacitetit të ndërmarrjeve përpunuese.
Kështu duke lënë një hapsirë tregu me kërkesë prej 123 milion litra qumësht në vit, e cila paraqet diferencën në mes të kërkesës nga përpunuesit dhe ofertës nga fermeri. Në mënyrë që fermerët Kosovarë të furnizojnë këtë treg të sigurtë, duhet të konsiderohet shtimi i numrit të lopëve për rreth 20,000 krerë dhe njëkohësisht aplikimi i praktikave të mira të menaxhimit të fermës për të rritur rendimentin aktual.

Shitja dhe Çmimi i tregut

Në vitin 2019, çmimi mesatar i tregut me pakicë për qumështin vendor sillet 0.45 - 0.50 Euro /litër, çmimi i qumështit të freskët të pasterizuar është rreth 0.50 Euro /litër ndërsa i atij të trajtuar me UHT, është rreth 0.90 Euro /litër.

Çmimi i shitjes së qumështit nga ferma tek qumështoret shënon një rënie në sezonën e pranverës dhe arrin në minimum ngase rritet oferta, e cila sezonë zakonisht fillon në muajin Maj. Pastaj, prodhimi i qumështit zvogëlohet deri sa të fillon "tharja e lopëve" gjatë sezonit vjeshtë / dimër, në të ciën periudhë ato nuk mjelen për dy muaj. Gjatë kësaj periudhe rritet kërkesa për qumësht prandaj edhe çmimi është më i lartë.

Produkti	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Qumësht	0.32	0.33	0.33	0.30	0.30	0.31	0.31	0.32
Norma		3.1%	0.0%	-9.1%	0.0%	3.3%	0.0%	3.2%

Tabela 3: Çmimet mesatare vjetore të shitjes me shumicë së qumështit nga ferma te qumë shtoret 2012 -2019

Konsumi

Konsumi vjetor i produkteve të qumështit në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 289 milion kg, duke llogaritur 166 kg / vit për kokë banori, apo 0.5 kg / ditë për kokë banori. Nëse përllogaritet që përpunuesit vendor industrial kanë hise prej vetëm 33% të tregut të produktit final, atëherë del se shumica e sasisë së qumështit të prodhuar në vend konsumohet brenda familjeve ku prodhohet dhe nuk përfundon tek përpunuesit industrial të cilët kanë kërkesa të vazhdueshme.

Për ta zëvendësuar pjesërisht këtë import me produkte vendore, furnizimi me qumësht të freskët nga prodhuesit vendor duhet të rritet për rreth 123 milion litra në vit, ashtu që përpunuesit industrial vendor të mund të plotësojnë kapacitetet e tyre të instaluara. Një sasi e tillë do të ndihmonte prodhuesit vendor të marrin pjesë më të madhe në tregun e Kosovës, por poashtu do të rriste konkurrentshmërinë e tyre në tregje të eksportit.

Gradualisht, konsumi do të lëvizte nga prodhimi për konsum vetanak, në konsum të produkteve të përpunara dhe paketuara. Për të arritur këtë sasi shtesë të prodhimit të qumështit, vlerësohet së numri i lopëve qumështore në Kosovë ka hapsirë të rritet për rreth 20,000 krerë.

SHEMBULL I BIZNESIT NË NJË FERMË

Për qëllime ilustrimi kemi paraqitur një rast hipotetik të investimit në një fermë me gjashtë (6) lopë qumështore e cila rritet më vonë në një fermë me 12 lopë (brenda dy viteve). Që nga viti i parë i funksionimit të kësaj fermë, kemi paraqitur një ilustrim të investimeve të nevojshme, shpenzimeve operative, shpenzimeve të punës, si dhe pasqyrave financiare të parashikuara me shitjet, fitimet dhe rrjedhën e parasë në bazë vjetore derisa ferma të bëhet një fermë me funksionim të plotë.

Rentabiliteti pas laktacionit të tretë

Meqenëse një mëshqerre i duhet të paktën një vit e gjysmë të rritet nga viçi dhe nëntë muaj të tjerë për t'u bërë lopë dhe gjatë kësaj kohe nuk jep asnjë kontribut në të ardhurat e fermerit, atëherë nevojiten rreth tri periudha laktacionesh që fermeri të kalojë në rentabilitet duke mbuluar vetëm me koston e rritjes së lopës. Fitimi ia nis të gjenerohet pas laktacionit të tretë dhe qëllimi i fermerit është të përdorë lopën e qumështit më shumë se tre laktacione për të gjeneruar fitime tjera.

Shpenzimet

Shpenzimet në investim

Investimet kryesore në një fermë të lopëve qumështore përfshiejnë blerjen e lopëve dhe ndërtimin e strehimit për ato. Shembulli hipotetik supozon se madhësia fillestare e fermës do të jetë gjashtë lopë, që është një madhësi mesatare e fermës për Kosovë. Edhe pse fermat dallojnë sipas numrit të lopëve dhe llojit të shtallës, është llogaritur që rreth 1,100 Euro investim kërkohen për të siguruar strehimin e duhur për një lopë qumështore. Pjesa tjetër e investimeve ndryshon bazuar në automatizimin e ushqimit, qumështit dhe zgjidhjeve për trajtimin e plehut organik. Fermerët kosovarë preferojnë grazhdet e ushqimit që iu përshtatën sistemit të lidhur të mbajtjes së lopëve. Pajisjet e ftohjes së qumështit janë të nevojshme për çdo fermë që numëron rreth 10 ose më shumë lopë, kështu sigurohet cilësi më e mirë të qumështit.

Sidoqoftë, supozohet se ferma hipotetike për të cilën janë bërë llogaritjet, do ta bëjë këtë investim pavarësisht se në fillim ka vetëm gjashtë lopë, pasi është paraparë që të rritet numri i krerëve në të ardhmen, atëherë kur fermeri vendos që të mos shesë viçat por t'i mbajë ata për prodhimin e qumështit. Në raste të tilla, investime shtesë prej rreth 280 Euro / viç janë të nevojshme për strehimin e tyre.

Teknologjia e nevojshme për mbajtjen fermës gjithashtu ndryshon nga ato të thjeshta deri tek ato të automatizuara për prodhimin e ushqimit. Por, githsesi traktori i thjeshtë dhe makina lidhëse janë të nevojshme për grumbullimin e sanës, prandaj ato qoftë mund të jenë në pronësi të fermerit ose të ofrohen si shërbime me pagesë. Në rastin e paraqitur këtu, supozohet se fermeri do të marrë me qira traktorin dhe pajisjet e paketimit të ushqimit për dy vitet e para të funksionimit, në mënyrë që të mos mbingarkojë rrjedhën e parasë. Ky investim mund të bëhet më vonë, atëherë kur ferma gjeneron para të mjaftueshme për të mbështetur investime të reja. Një kosto mesatare e investimeve të nevojshme është e paraqitur më poshtë:

Investimet	Sasia	Çmimi (Euro)	Totali (Euro)	Afati kohor
Strehimi i lopeve	6	1,100	6,600	Viti 1, dy faza
Strehimi i viçave femra	6	280	1,680	Viti 1, gjysma e dytë
Strehimi i viçave të rritur	6	1,100	6,600	Viti 3, gjysma e dytë
Makina për mjelje tëqumështit	1	380	380	Viti 1, gjysma e dytë
Rezervuari për ftohje të qumështit	1	1,800	1,800	Viti 1, gjysma e dytë
Traktori	1	10,500	10,500	Viti 3, gjysma e parë
Pajisjet për paketimin e ushqimit	1	11,150	11,150	Viti 4, gjysma e parë
Pajisjet për përgatitjen e tokës	1	1,820	1,820	Viti 3, gjysma e dytë
Blerja e lopëve	6	1,400	8,400	Viti 1, gjysma e dytë
Investimet totale			**48,930 Euro**	

Tabela 4: Investimet fikse në një fermë tipike të lopëve qumështore

Kostot operacionale

Pjesa më e madhe e shpenzimeve operacionale për një fermë të lopëve qumështore shkon në prodhimin e ushqimit të kafshëve. Këto investime më tutje ndahen në ushqim voluminoz dhe koncentrat. Shpenzimet e punës janë një tjetër grup i rëndësishëm i shpenzimeve operacionale, detajet për të cilat janë dhënë më poshtë. Shpenzimet veterinare, energjia elektrike, qiraja, amortizimi dhe shpenzimet e interesit janë gjithashtu të rëndësishme dhe duhet të merren parasysh gjatë llogaritjes së profitit për një ferme qumështore. Tabela më poshtë paraqet supozimet kryesore të përdorura për të llogaritur shpenzimet operacionale për fermën hipotetike të synuar:

Shpenzimet operacionale	Supozimet
Ushqimi voluminoz:	Eshtë llogaritur një mesatare për një lopë qumështore e cila konsumon rreth 28 kg/ditë ushqim voluminoz (lopët qumështore konsumojnë deri në 31 kg/ditë, por gjatë periudhave të thata ato konsumojnë më pak). Çmimi i ushqimit voluminoz është rreth 0.03 Euro / kg, por çmimi i ushqimit voluminoz rritet rreth 50% në mungesë të traktorit dhe pajisjeve për paketim të ushqimit.
Koncentrati:	Një lopë qumështore konsumon rreth 7 kg koncentrat në ditë si mesatare. Çmimi i koncentratit është llogaritur të jetë 0.22 Euro/kg. mirëpo sikurse tek ushqimi voluminoz, ashtu edhe për koncentrat rritet kostoja për 50% nëse f ermri nuk mund të përgatisë vetë atë.
Shpenzimet veterinare:	Shpenzimet veterinare ndryshojnë nga viti në vit. Mirëpo supozohet që për një vit të plotë, shpenzimet e përgjithshme veterinare arrijnë në rreth 200 Euro për gjashtë lopë. Për qëllime kalkulimi, është supozuar që një fermer shpenzon rreth 3 Euro/muaj për një lopë.
Nafta për gjenerator elektrik:	Supozohet që fermeri çdo muaj shpenzon rreth 1 Euro / lopë për naftë të gjeneratorit elektrik.
Shpenzimet e qirasë:	Në rastet kur fermeri nuk ka tokë të vetën, ajo mund të merret me qira. Standardet e industrisë për prodhimin e ushqimit për një lopë qumështore kërkojnë minimum 0.6 Ha /lopë. Shpenzimet e qirasë për një hektar është rreth 80 Euro, që rezulton në 480 Euro / vit për 6 lopë dhe 960Euro / vit për 12 lopë
Shpenzimet e fuqisë punëtore:	Një ferme prej gjashtë lopëve i duhet një i punësuar me orar të plotë dhe një punëtor sezonal. Të dy pritet të paguhen me një pagë prej rreth 200 Euro / muaj. Përderisa punëtori me orar të plotë punon gjatë gji thë vitit, punëtori sezonal do të inkuadrohet për të ndihmuar prodhimin e ushqimit vetëm gjatë muajve Mars, Prill, Shtator dhe Tetor. Me rritjen e numrit të lopëve rritet edhe numri i punëtorëve sezonal.
Shpenzimet e zhvlerësimit:	Të gjitha asetet fikse t ë prezentuara në tabelën e investimeve janë zhvlerësuar duke përdorur metodën e zhvlerësimit të drejtë, përfshier edhe lopët qumështore të cilat zhvlerësohen për një periudhë 5.5 vjet. Pajisjet janë zhvlerësuar për periudhen pesë vjeçare, ndërsa objektet janë zhvlerësuar për periudhën 10 vjeçare. Këto kalkulime janë konsideruar në baza mujore.
Shpenzimet e kamatës:	Për të financuar investim et e parashikuara, supozohet se fermës i nevojitet një kredi prej 15,000 Euro me kamatë vjetore prej 8% me një vit pe riudhë pritje. Si shtesë, në vitin 3 supozohet edhe një kredi prej 10,500 Euro për të paguar traktorin.
Shpenzimet e mirëmbajtjes:	Për të mbajtur higjenën e shtallave në nivel të lartë, është llogaritur që fermerët të shpenzojnë rreth 10 Euro / lopë / mu aj.

PRODHIMI DHE SHITJET

Qumështi

Prodhimi i qumështit - për një fermë prej gjashtë lopësh lidhet drejtpërdrejtë me numrin e lopëve produktive. Bazuar në një rendiment mesatar prej 24 litrash / ditë për një lopë qumështore gjatë periudhës së laktacionit, rezulton në rreth 730 litra për lopë në muaj dhe 8,760 litra për lopë në vit. Sasia e përgjithshme e qumështit për një mesatare prej pesë lopëve në prodhim është 3,650 litra në muaj dhe 44,000 litra në vit. Çmimi i pritshëm për litër të qumështit është rreth 0.33 Euro.

Prodhimi i qumështit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Nr. i lopëve	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6
Rendimenti i qumështit / lopë / ditë	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24
Ditët në muaj	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31
Rendimenti i qumështit / lopë / muaj	744	672	744	720	744	720	744	744	720	744	720	744
Nr. Mesatar i lopëve produktive	6	6	6	6	6	3	3	3	4	5	6	6
Litra/muaj	4,464	4,032	4,464	4,320	4,464	2,160	2,232	2,232	2,880	3,720	4,320	4,464
Litra / vit	43,752											

Tabela 5: Modeli i prodhimit të qumështit për një fermë tipike me gjashtë lopë

Viçat

Ferma e qumështit pritet të prodhojë çdo vit rreth gjashtë deri në dymbëdhjetë viça, varësisht nga numri i lopëve. Supozimet e mëposhtme u përdorën për të llogaritur numrin e viçave të shitur dhe numrin e viçave të ruajtur në fermë.

Lopë	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
Nr. i Lopëve / Vit	6	6	12	12	12
Nr. i Viçave të shitur / Vit	0	6	12	12	12

Tabela 6: Numri i viçave të shitur ndaj viçave të mbajtur

Siç mund të vërehet, në vitet e para të funksionimit, një fermë standarde do të mbajë disa nga viçat për prodhimin qumështit. Në vitet e ardhshme, viçat shiten për të gjeneruar të ardhura. Duhet gjithashtu të theksohet se gjatë gjithë shembullit të dhënë supozohet se të gjithë viçat që mbahen në fermë janë femra. Kjo vlen edhe në rastet kur viçi është i gjinisë mashkullore, fermeri mund ta shkëmbejë atë në treg me një viç femër gati për të njëjtën çmim.

Burimi i të ardhurave në fermë

Ferma hipotetike e paraqitur këtu për qëllime ilustrimi pritet të gjenerojë të ardhura nga tri burime kryesore:

- Prodhimi i qumështit
- Shitja e viçave
- Subvencionet

Të ardhurat mujore dhe vjetore nga qumështi i prodhuar në fermë janë llogaritur në bazë të çmimit mesatar të tregut. Shitjet mujore të qumështit për një vit tipik janë paraqitur më poshtë:

Prodhimi i qumështit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Sht	Tet	Nën	Dhj
Nr. Mestar i lopëve produktive	6	6	6	6	6	3	3	3	4	5	6	6
Litra/Muaj	4,464	4,032	4,464	4,320	4,464	2,160	2,232	2,232	2,880	3,720	4,320	4,464
Litra / Vit	43,752											
Çmimi i qumështit (Euro)	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33
Të ardhurat nga qumështi	1,473	1,331	1,473	1,426	1,473	713	737	737	950	1,228	1,426	1,473
Euro / vit	14,438.00											

Tabela 7: Shitjet mujor e të qumështit në një fermë tipike

Shitja vjetore e qumështit, duke supozuar që viti 1 llogaritet si vit përgatitor pasi zënë vend investimet, pritet të jetë si në vijim:

Shitjet	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
Prodhimi total (Litra)	15,384	43,752	54,792	78,840	78,840
Çmimi mesatar i shitjes (Euro)	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33
Të hyrat totale nga qumështi (Euro)	5,269	14,438	18,081	26,017	26,017

Tabela 8: Të hyrat vjetore nga shitja e qumështit

Pastaj, ferma pritet që të sigurojë të hyra nga shitja e viçave. Shitjet vjetore zakonisht janë si në vijim:

Viçat	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
Nr. i Viçave / Muaj	6	6	12	12	12
Nr. i Viçave të shitur /Vit	-	6	12	12	12
Çmimi Mesatar (Euro)	280	280	280	280	280
Të hyrat totale nga shitja e viçave (Euro)	-	1,690	3,440	3,440	3,440

Table9: Të ardhura vjetore nga shitja e viçave

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural jep subvencione për ferma. Një fermë qumështore do të merrte në mënyrë tipike dy lloje subvencionesh: subvencion / kokë bagëtish dhe subvencione për qumësht (bazuar në cilësinë e qumështit). E para jepet një herë në vit ndërsa e dyta jepet katër herë në vit. Tabela më poshtë paraqet vlerësimet për një fermë prej gjashtë lopësh:

Të hyrat nga subvencionet		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
Subvencionet për krerë	70 €/kokë	-	840	420	840	840
Subvencionet për cilësi të qumështit	0.04 €/Lit	500	1,750	2,192	3,154	3,154
Të hyrat totale nga subvencionet (Euro		500	2,590	2,612	3,994	3,994

Table10: Të ardhurat vjetore nga subvencionet për një fermë tipike qumështore

Pasqyra e të ardhurave

Në këtë shembull hipotetik paraqiten të ardhurat për pesë vitet e para të biznesit. Shembulli i paraqitur është bazuar në supozimet për shitjet dhe shpenzimet e një ferme prej gjashtë lopësh. Supozohet se tatimi mbi të ardhurat prej 3% paguhet nga qendra e grumbullimit të qumështit. Pasqyra vjetore e të ardhurave për një periudhë pesë-vjeçare, ku Viti 1 është viti i përgatitjes, paraqitet më poshtë:

Pasqyra e të ardhurave	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
Shitjet					
Të hyrat totale nga shitja e qumështit	5,269	14,438	18,081	26,017	26,017
Të hyrat totale nga shitja e viçave	-	1,690	3,440	3,440	3,440
Të hyrat totale nga subvencionet	500	2,590	2,612	3,994	3,994
Të hyrat totale	5,769	18,718	24,133	33,451	33,451
Shpenzimet					
Kostoja e ushqimit voluminoz	2,759	2,759	3,091	4,414	3,679
Kostoja e koncentratit	1,691	5,059	5,668	8,092	6,745
Shpenzimet veterinare	72	216	279	432	432
Karburanti për gjenerator elektrik	-	-	93	144	144
Shpenzimet elektrike	48	144	186	288	288
Qiraja e tokës/kok[/Ha	480	480	720	960	960
Shpenzimet e punëtorëve:					
Punëtor me orar të plotë	2,000	2,400	2,400	2,400	2,400
Punëtor sezonal	-	200	1,200	1,600	1,600
Shpenzimet totale të zhvlerësimit	1,141	2,791	6,361	9,673	9,673
Shpenzimet e kamatës	1,000	1,138	1,208	1,436	1,033
Shpenzimet e mirëmbajtjes	240	720	930	1,440	1,440
Shpenzimet totale	9,431	15,907	22,136	30,879	28,393
Fitimi para tatimit	-3,662	2,811	1,997	2,572	5,057

Table 11: Pasqyra Vjetore e të Ardhurave të parashikuara

Rrjedha e parasë

Pasqyra e rrjedhës së parasë për një fermë hipotetike gjithashtu është përgatitur më poshtë për të treguar dinamikën e ndryshimit të parasë gjatë blerjeve dhe shitjeve në biznesin e fermës. Supozimet e mëposhtme janë bazuar në:

- **Shitje:** Të hyrat nga shitja e qumështit supozohet të arkëtohen në muajin vijues. Kjo paraqet një periudhë mesatare për nënsektorin e qumështit.
- **Shitje:** Të hyrat nga shitjet e viçave supozohet të arkëtohen nga pika e shitjes.
- **Shitje:** Të hyrat nga subvencionet pritet të arkëtohen një muaj pasi ato të shpallen.
- **Shpenzime:** Të gjitha shpenzimet, personeli dhe operacionet, supozohet se paguhen në të njëjtin muaj që ato ndodhin.
- **Investime:** Investimet fillestare në ndërtim dhe blerjen e lopëve realizohen në vitin e parë. Makina e qumështit dhe rezervuari për ftohje të qumështit gjithashtu blehen në vitin 1. Shtalla e viçave përgatitet nëse fermeri vendos t'i mbajë ato në fermë. Nëse ato mbahen, gjatë rritjes së tyre kërkohet investim i mëtutjeshëm në objekt dhe kjo bëhet në vitet e ardhshme. Për shembull, për viçat e vitit të parë, investimi në shtallën e duhur të lopëve bëhet në vitin 3, e kështu me rradhë. Traktori, pajisjet për përgatitjen e tokës dhe pajisjet për paketimin e ushqimit të kafshëve blehen në Vitin 3 dhe 4, në mënyrë që të mos mbingarkojnë rrjedhën e parasë në vitet fillestare.

- **Struktura e financimit:** Përveç kredisë prej 15,000 Euro, supozohet se pjesa tjetër e investimit në vitin 1 mbulohet nga kapitali prej 15,000 Euro. Në vitin 3, një kredi tjetër prej 10,500 Euro supozohet se e mbulon koston e blerjes së traktorit. Pjesa tjetër e investimeve financohet nga të ardhurat operative.

Për të ilustruar se si ndikojnë kushtet e pagesës, në rrjedhën vjetore të parasë së një ferme, është paraqitur tabela si më poshtë:

Pasqyra e rrjedhës së parasë	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
Cash Flows from Operations:					
Të hyrat e arkëtuara nga shitja e qumështit	5,269.00	14,438.00	18,081.00	26,017.00	26,017.00
Të hyrat e arkëtuara nga shitja e viçave	-	1,690.00	3,440.00	3,440.00	3,440.00
Të hyrat e arkëtuara nga subvencionet (krerë)	-	840.00	420.00	840.00	840.00
Të hyrat e arkëtuara nga subvencionet (qumësht)	500.00	1,750.00	2,192.00	3,154.00	3,154.00
Të hyrat totale të arkëtuara	5,769.00	18,718.00	24,133.00	33,451.00	33,451.00
Shpenzimet për ushqim	-4,450.00	-7,818.00	-8,759.00	-12,506.00	-10,424.00
Shpenzimet veterinare	-72.00	-216.00	-279.00	-432.00	-432.00
Shpenzimet elektrike	-48.00	-144.00	-279.00	-432.00	-432.00
Shpenzimet për qira	-480.00	-480.00	-720.00	-960.00	-960.00
Shpenzimet për paga	-2,000.00	-2,600.00	-3,600.00	-4,000.00	-4,000.00
Shpenzimet për mirëmbajtje	-240.00	-720.00	-930.00	-1,440.00	-1,440.00
Shpenzimet totale	-7,290.00	-11,978.00	-14,567.00	-19,770.00	-17,688.00
Totali i shpenzimeve operacionale	-1,521.00	6,740.00	9,566.00	13,681.00	15,763.00
Shpenzimet e investimeve:					
Investimet në objekt	-6,600.00	-	-6,600.00	-	-
Investimet në grazhd për Viça / femra	-1,680.00	-	-	-	-
Investimet në pajisjet mjelëse	-380	-	-	-	-
Investimet në rezervuar për ftohje të qumështit	-1,800.00	-	-	-	-
Investimet në Traktor	-	-	-10,500.00	-	-
Investimet në pajisjet për paketim të ushqimit	-	-	-	-11,150.00	-
Pajisjet për përgatitje të tokës	-	-	-1,820.00	-	-
Blerja e lopëve	-8,400.00	-	-	-	-
Shpenzimet totale në investime	-18,860.00	0.00	-18,920.00	-11,150.00	0.00
Paratë nga financimi:					
Investime kapitale	15,000.00	-	-	-	-
Kredia	15,000.00	-	10,500.00	-	-
Pagesa e kredisë	-1,000.00	-3,241.46	-4,501.36	-6,204.58	-6,204.58
Paraja totale nga financimet	29,000.00	-3,241.46	5,998.64	-6,204.58	-6,204.58
Paratë e gatshme në fund	8,619.00	12,117.54	8,762.18	5,088.60	14,647.02

Table 12 - Pasqyra e rrjedh ës së parasë vjetore - e parashikuar

Për më shumë informata vizitoni:

WWW.AGRO.RECURA.BIZ